



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2024:220044
Datë: 26.08.2024
Numri i dokumentit: 06084608

KF.nr.460/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik NULI, në kontestin tregtar-administrativ të paditësit Biogrow Sh.P.K. me seli Istog, Rr. Asllan Beka, nr. 57, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti vlerësim tatimor, vlerë kontesti e pa përcaktuar, duke vepruar sipas parashtrësës së paditësit të datës 19.08.2024, me datën 26.08.2024, jashtë seance mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. PEZULLOHET procedura në kontestin tregtar-administrativ KF.nr.460/24, sipas padisë së paditësit Biogrow Sh.P.K. me seli Pejë, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, për anulimin e vendimit nr.prot.259/24 të datës 05.07.2024, për shkak se paditësi ka hequr dorë nga padia.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi Biogrow Sh.P.K. me seli Pejë, ka paraqitur në Gjykatë padi për anulimin e vendimit me nr. prot. 259/24 të datës 05.07.2024.

Paditësi, me parashtrësën e dorëzuar në Gjykatë me datën 19.08.2024, ka kërkuar tërheqjen e padisë me shenjën KF.nr.460/24 të parashtruar nga paditësi pranë kësaj Gjykate kundër të

paditurit Administrata Tatimore e Kosovës, lidhur me çështjen juridike për anulimin e vendimit nr. prot. 259/24 të datës 05.07.2024.

Duke marrë për bazë faktin se paditësi ka hequr dorë nga padia dhe bazuar në dispozitat e nenit 31 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, me të cilën thuhet se “*Paditësi mund të heq dorë nga padia derisa të mos merret vendimi*”, gjykata konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore për ta PEZULLUAR procedurën në këtë kontest tregtar administrativ, komfor nenit 31, paragrafi 1, të Ligjit nr.03/L-202, për Konfliktet Administrative, prandaj Gjykata nuk është lëshuar më tej në vendosje sipas padisë.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës e ka marrë bazuar në nenin 64 të LKA-së.

Duke marrë parasysh të lartcekurat, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 31 par.1 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.460/24, datë 26.08.2024

G j y q t a r i
Fisnik NULI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.